



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202000067/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Kavajë.*

**Drejtuar:** **Z. Sali SKURRA**  
Shef i Komisariatit të Policisë Kavajë

**KAVAJË**

**Për dijeni:** **Drejtues i parë Rebani JAUPI**  
Drejtori i Drejtorisë Vendore të Drejtorisë Tiranë

**TIRANË**

*I nderuar z. Skurra,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup> bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Kavajë.

Inspektimi u krye në datën 23.12.2019, sipas një plani inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Besnik Deda dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

<sup>1</sup> Neni 74/1 I ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Pë të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetas të privuar nga liria, në mungesë dhe me porosi të shefit të Komisarariatit të Policisë Kavajë, z.Sali Skurra, grupi i inspektimit u takua me përgjegjësin e dhomave të sigurisë dhe punonjësin e zyrës të informacionit të këtij komisarati, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Grupi i inspektimit, në vijim inspektoi kushtet në të cilën ndodhen ambjenti i shoqërimit dhe i sigurisë, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Punonjësit e policisë me të cilët u kontaktua, u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë inspektimit, që zhvilloi grupi i inspektimit në ambjentet e këtij komisarati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

1. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për plotësimin me përgjegjësi dhe saktësi të të gjitha rubrikave të “Regjistrin të evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar”, si dhe të dokumenteve të tjera të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore lidhur me të shoqëruarit.
2. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për sigurimin e ndriçimit në tualetin e përbashkët dhe sigurimin e ujit të ngrohtë për larjen e trupit të personave të ndaluar/arrestuar, në ambientin e sigurisë.
3. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për paisjen e të ndaluarve/arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, letra higjienike dhe për fshirjen e duarve etj.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se, nuk ishin realizuar rekomandimet e mëposhtme:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për miratimin në organikën e Komisarariatit të Policisë Kavajë të mjekut/ndihmësmjekut, i cili siguron vizitën mjekësore dhe plotësimin e kartelës mjekësore për personat e ndaluar/arrestuar brënda 12 orëve nga momenti i arrestimit sipas parashikimeve ligjore.
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për miratimin në organikë të një psikologu, si pjesë e rëndësishme e të gjithë procesit të hetimit të personave të ndaluar/arrestuar të mitur.
3. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin më vete të dhomës së mjekut dhe paisjen e saj me bazën materiale të nevojshme.
4. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për eliminimin e plotë të lagështirës në dhomat e sigurisë dhe dhomat e shoqërimit.
5. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për paisjen me kamera të dhomës për marrjen në pyetje të ndaluarve/arrestuarve nga prokurorët e çështjeve.

Në përfundim të inspektimit u konstatua se, megjithëse në Komisarariatit të Policisë Kavajë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të

personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarriatin e Policisë Kavajë, mjedisi i shoqërimit ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisarriatit dhe kishte 3(tre) dhoma shoqërimi. Ato ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme dhe të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur. Dritaret e dhomave kishin përmasa të cilat mundësonin sigurimin e plotë të ajrimit dhe ndriçimit natyral. Ndërsa ndriçimi artificial, sigurohej nga rrjeti elektrik.

Dhoma e shoqërimit që përdorej për qëndrimin e personave të rritur, nuk ishte e pajisur me asnjë orendi si tavolina pune dhe karrige për qëndrimin ulur të këtyre personave. Ndërsa, dhoma e shoqërimit për femra dhe të mitur, kishin tavolina pune dhe karrige për qëndrimin ulur të tyre. Në koridorin e ambientit të shoqërimit, ndodheshin dhoma për njohjen e personave dhe ajo për përgjimin natyral.

Ndërkohë, u konstatua se këtij ambienti i mungonte dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë. Sipas informacionit, marrja në pyetje dhe intervistimi i të shoqëruarve, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë, të cilat nuk ishin të monitoruara me sistemin audio-viziv të kamerave. Koridori dhe ambientet e shoqërimit vëzhgoheshin nga sistemi i kamerave.

Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodhej një tualet i përbashkët për meshkuj dhe femra, i cili kishte ujë të rrjedhshëm.

Mjedisi dhe dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por ato kishin nevojë për lyerje dhe dezinfektim të herë pas herëshëm të këtyre ambienteve.

Në mjedisin dhe në dhomat e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Të shoqëruarit qëndronin në dhoma të mbyllura me çelës, ndërsa dritaret e dhomave në pjesën e jashtme ishin të siguruara me rrjetë të hollë hekuri, për arsye sigurie të personave që qëndrojnë në këto ambiente.

Në korridorin e këtij ambienti ishin vendosur postera me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Ambjenti i sigurisë në Komisarriatin e Policisë Kavajë, në tërësi ishte i ndërtuar konform normave, kushteve dhe standardeve për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, që përcaktohen në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambjenti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisariatit, në kushte të plota ruajtje dhe sigurie. Ai kishte 3(tre) dhoma sigurie, të ndara më vete për personat e ndaluar/arrestuar të rritur, femra dhe të mitur. Dhomat e sigurisë ishin të ndërtuara me dhomë dhe paradhomë, të ndarë në mes me derë dhe skarë hekuri, si dhe kishin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në procedurën standarde. Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për mbajtjen dhe sigurimin e 3(tre) personave.

Dhomat e sigurisë ishin të pajisura me orenditë dhe materialet e nevojshme për qëndrim dhe jetesë normale, si krevat, batanije dhe jastëk. Në secilën dhomë kishte tualete, ndërsa dushi për larjen e trupit kryhej në një ambient më vete.

Dhoma që përdorej për vizitat mjeksore ishte e përbashkët me zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë. Ajo ishte e pajisur me orendi si tavolinë pune, karrige, krevat, rafte për mbajtjen e dokumentacionit dhe kartelave mjeksore. Nisur nga standardet, dhoma e mjekut nuk plotësonte kushtet për kryerjen e vizitave mjeksore.

Në koridorin e ambientit të sigurisë ndodhej edhe dhoma për marrjen në pyetje dhe për takime me avokatin të personave të ndaluar/arrestuar, e cila ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige prej druri, të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme, për të qëndruar ulur përfaqësuesi i organit të akuzës, avokati dhe i ndaluar/arrestuari.

Gjatë inspektimit, në ambientin e sigurisë nuk u gjetën sende që shkaktojnë/eksponojnë dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit.

Ambjenti i sigurisë nuk kishte sistem ngrohje qëndror, por komisariati kishte marrë masa për sigurimin e pajisjeve elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Dhomat e sigurisë dhe ambientet e tjera, ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Tualetet dhe dushi për larjen e trupit të personave të ndaluar/arrestuar, kishin furnizim me ujë të rrjedhshëm.

Koridori, hyrja e dhomave të sigurisë, dhoma e marrjes në pyetje dhe ambientet e jashtme të sigurisë, ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në koridorin e ambientit të sigurisë ishte instaluar telefon fiks për kontakt të punonjësve të shërbimit në rast nevojë, si dhe në muret e dhomave të sigurisë kishte të montuar buton zileje/sinjali, për kontaktin e të ndaluarit/arrestuarit me punonjësit e policisë në rast nevojë.

Në disa ambiente të dhomave të sigurisë, ishte evidente lagështia në muret e dhomave të sigurisë. Në këto kushte, është e nevojshme ndërhyrja e herpashershme me investime për mirëmbajtjen e tyre dhe eliminimin e erës së mykut.

Në koridorin e ambientit të sigurisë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar. Në kohën e inspektimit, në ambientin e sigurisë ndodhej 1(një) person, që ishte në pritje të vleftësimit të masës të sigurisë nga gjykata.

## **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i tyre**

Në Komisariatin e Policisë Kavajë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

*Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se:*

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë. Të gjitha rubrikat e këtij regjistri ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarjat evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij, nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Nga kqyrja e regjistrave rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, në procesverbalin e përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore, ora e arrestimit në flagrancë të personave, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Gjithashtu, u konstatua se në ambientin e sigurisë të këtij komisarjati, mbahej regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të ndaluar/arrestuar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2019 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga shtetasit.

## **Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe të shoqëruarve në ambientet e policisë**

Në kohën e inspektimit në Komisarjatin e Policisë Kavajë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë, ndodhej 1 (një) person i arrestuar.

Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit intervistoi personin e arrestuar, i cili konfirmoi se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Nga i intervistuari nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarit ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi.

Shtetasi i intervistuar kishte dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishte marrë kontakt dhe kishte kryer veprimet procedurale.

Të ndaluarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë me shërbimin catering, sipas normave për trajtimin me ushqim, të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit

nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore, kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Gjatë inspektimit, u konstatua se vizitat mjekësor të personave në ambientin e sigurisë, nuk kryhen rregullisht brenda afatit 12 orë pas ndalimit/arrestimit të tyre, nga mjeku/ndihmësmjeku i DVP Tiranë. Kjo për arsye të largësisë dhe dinamikës që ka drejtoria dhe komisaritet e tjerë në varësi të DVP Tiranë. Ky shqetësim është i përsëritur dhe në inspektimin e mëparshëm të Avokatit të Popullit, ndaj është e nevojshme miratimi në organikë për një mjek/ndihmësmjek pranë kësaj drejtorie, që të përballojë kryerjen e vizitave dhe trajtimin mjekësor të personave të ndaluar/ arrestuar, në afatet e përcaktuara sipas procedurës standarde<sup>2</sup>.

Gjithashtu, dhoma e mjekut nuk ishte sipas standardeve, pasi vizitat mjeksore kryheshin në të njëjtin ambient ku zhvillonte aktivitetin përgjegjësi i dhomave të sigurisë. Ruajtja dhe siguria e ilaçeve e medikamenteve mjeksore, nuk ishte e garantuar në kushtet që ndodhej ky ambient.

Sipas informacionit, nga drejtuesit e komisaritetit, ishin marrë masa që vizita mjeksore dhe trajtimi shëndetësor i personave të ndaluar/arrestuar, të mbulohej nga mjekët e urgjencës të spitalit rajonal Kavajë.

Gjithashtu, në rastet e të shoqërimit në mjediset e policisë të personave të mitur, nuk kishte një psikolog të parashikuar në organikën e këtij komisariteti. Në rastet kur punonjësit e policisë duhet të merren në pyetje personin e mitur, duhet të kontaktonin me Bashkinë Kavajë, shkollën e mesme të qytetit Kavajë ose ishin në pritje të psikologut në organikë të DVP Tiranë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Koha e qëndrimit të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaritetin e Policisë Kavajë, punonjësit e policisë i kryenin veprimet proceduriale personat e shoqëruar në zyrat e punës, në mungesë të një dhome të posaçme dhe të përshtatshme për marrjen në pyetje të shtetasve. Zyrat e punonjësve të policisë, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Ndërsa, në ambientin e sigurisë ishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës, si edhe për takim me avokatët. Ky ambient ishte i monitoruar me kamera, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore.

---

<sup>2</sup> *Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".*

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit<sup>3</sup>.

Gjithashtu, në Komisaratin e Policisë Kavajë, nuk kishte një dhomë me hapësirë dhe kushte të përshtatshme, për intervistimin e personave të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Nga monitorimi që u bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Gjatë inspektimit u konstatua se, personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar ishin të njoftuar nga punonjësit e policisë të komisarariatit, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, të kërkonin ndihmë juridike për t'ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut.

Në këtë komisarariat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimitin e çështjes përkatëse. Nga inspektimi, rezultoi gjithashtu se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Në rastin e ndalim/arrestimit të personave me shtetasi të huaj, ju ofrohej dhënia e deklaratës në 6 gjuhë të huaj, ku parashikoheshin të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të*

---

<sup>3</sup>“Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” *CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]*

*drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për kryerjen e vizitave mjekësore jo më vonë se 12 orë pas ndalimit/arrestimit, nga mjeku apo ndihmësmjeku i drejtorisë/komisariatit policisë, si dhe plotësimin e kartelës mjekësore për secilin person të ndaluar/arrestuar.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e plotë të lagështirës në dhomat e sigurisë dhe dhomat e shoqërimit.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e dhomës së shoqërimit, ku mbahen dhe trajtohen personat e rritur, me karrige për qëndrimin ulur të këtyre personave.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e dhomës me vete të mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe paisjen e saj me orenditë, bazën materiale dhe medikamentet e nevojshme mjekësore.
5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, para se të kalojnë në ambientin e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit audio-viziv brenda kësaj dhome.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**